

VENDIM
Nr. 88/2025

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KOMISIONIT RREGULLATOR
TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 13, 15 dhe 17, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në kandidaturat e përzgjedhura nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Shqyrtimin dhe Përzgjedhjen e Kandidaturave të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Zgjedhjen e zotit Dritan Çaka anëtar të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.